

VENDIM
Nr.50, datë 18.8.2006

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT PËR ÇMIMIN E SHITJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA SHOQËRIA “JUANA” SHPK PËR VITIN 2006**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.26, datë 13.05.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.05.2005, neni 11, germa A, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 18.08.2006, pasi verifikoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Juana” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2006,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për shoqërinë “Juana”sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2006.

2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për shqyrtimin e aplikimit të paraqitur nga shoqëria “Juana” sh.p.k. brenda afateve të përcaktuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta